



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:247347

Datë: 12.04.2023

Numri i dokumentit: 04222908

2021:250047

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurve A.I. për shkak të veprës penale, organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së si dhe J.S., B.I., A.T., A.B., M.R., R.M. dhe S.M., për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/IL.nr.1682/2021 të dt.05.11.2021, ka mbajtur shqyrtimin fillestar publik më datë 06.04.2023, në prani të Prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, të pandehurit të parë dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Rafiz Shehu, të pandehurit të dytë dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Ramadan Sylejmani, të pandehurit të tretë dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Kemajl Ademaj, të pandehurit të katërt dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Nexhat Qorrolli, të pandehurit të pestë dhe mbrojtëses së tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Qëndresa Lajqi-Bajraktari, të pandehurit të gjashtë dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Samir Rekaj, të pandehurit të shtatë dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Elvira Heta-Vata dhe të pandehurit të tetë dhe mbrojtëses së tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Kushtrim Obrazhda dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 12.04.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

A.I., nga i ati M. dhe e ëma Gj. e gjinisë .. i lindur me në fsh. K....., Komuna Ferizaj ku dhe tani jeton, me nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, kamerier, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

J.S., nga i ati Sh. dhe e ëma M. e gjinisë H., i lindur me në Ferizaj, me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, me nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, kamerier, beqar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

B.I., nga i ati M. dhe e ëma M. e gjinisë B., i lindur me, në Ferizaj, me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar babë i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

A.T., nga i ati I. dhe e ëma M. e gjinisë D., i lindur me, në Ferizaj ku dhe tani jeton Rruga''.....''pn. me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pamartuar, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

A.B., nga i ati J. e ëma Xh. e gjinisë A., i lindur me, në fshatin J....., me vendbanim në fshatin, Komuna Shtime, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

M.R., nga i ati J. dhe e ëma N. e gjinisë B., i lindur me në fshatin K....., Komuna Ferizaj ku dhe tani jeton, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

R.M., nga i ati N....., e ëma Sh..... e gjinisë B....., i lindur me në Ferizaj, me vendbanim në fshatin K....., Komuna Ferizaj, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, shofer, i martuar baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

S.M., nga i ati M., e ëma H. e gjinisë F., i lindur me në, me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, me numër personal....., ka të kryer shkollën e mesme, mekanik, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

JANË F A J T O R

S E P S E

I

I pandehuri A.I.

Me datë 31 Tetor 2021, rreth 01:00, në fshatin ..., Komuna Ferizaj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, ka organizuar lojëra të llojit të bixhozit për të cilat nuk është dhënë leja i organit kompetent, në atë mënyrë që pas një kontrolli nga Njësia e Hetimeve e Stacionit Policor në Ferizaj, në lokalin e të pandehurit janë hasur duke luajtur bixhoz dhe janë gjetur në tavolinën e bilardos letra dhe qipa të cilët kanë shërbyer për lojëra të bixhozit-Pokerit,

me të cilën ka kryer veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK – së.

II

Të pandehurit

J.S., B.I., A.T., A.B., M.R., R.M. dhe S.M.

Me datë 31 Tetor 2021, rreth 01:00, në fshatin ..., Komuna Ferizaj, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, të pandehurit kanë qenë pjesëmarrës në lojëra të llojit të bixhozit për të cilat nuk është dhënë leja i organit kompetent, në atë mënyrë që pas një kontrolli nga Njësia e Hetimeve e Stacionit Policor në Ferizaj, janë hasur duke luajtur bixhoz dhe janë gjetur në tavolinën e bilardos letra dhe qipa të cilët kanë shërbyer për lojëra të bixhozit-Pokerit,

me të cilën kanë kryer veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK – së,

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 44, 69, 70 dhe 294 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 364, 452, 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit i :

G J Y K O N

Të pandehurin e parë, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim në gjobë në shumën prej 700 € / shtatëqind euro/.

Të pandehurin e dytë, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim në gjobë në shumën prej 400 € / katërqind euro/.

Të pandehurin e tretë, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim në gjobë në shumën prej 400 € katërqind euro/.

Të pandehurin e katërt, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim në gjobë në shumën prej 400 € / katërqind euro/.

Të pandehurin e pestë, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim në gjobë në shumën prej 400 € / katërqind euro/.

Të pandehurin e gjashtë, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim në gjobë në shumën prej 300 € / treqind euro/.

Të pandehurin e shtatë, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim në gjobë në shumën prej 400 € / katërqind euro/.

Të pandehurin e tetë, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 / gjashtë / muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim në gjobë në shumën prej 400 € / katërqind euro/.

Dënimet e shqiptuara me gjobë të pandehurit janë të obliguar ti paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se të pandehurit nuk i paguajnë dënimet me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, të njëjtëve dënimet do t'iu shndërrohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'iu llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej nga 20 Euro (njëzet euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë po ashtu secili veç e veç shumën prej nga 20 /njëzet/ Euro, që të dy shumat obligohen ti paguajnë brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Të pandehurve në kuptim të nenit 276 të KPPRK-së, u konfiskohen shtatë palë letra të bixhozit, një fletore për shënime dhe dy kutija të metalit me zhetona.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.1682/2021 të datës 05.11.2021, ka ngarkuar të pandehurit për kryerje të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK – së

dhe ka kërkuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe t'iu shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilat janë proceduar të pandehurit gjykohen nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 06.04.2023, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre të angazhuar sipas detyrës zyrtare.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat e tyre në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së. Dhe pasi që të pandehurit kanë deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe janë konsultuar mjaftueshëm me avokatet e tyre, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, ju ka afruar mundësinë secilit veç e veç që të deklarohen lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

I pandehuri i parë në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mundën të vijnë, pranimin e fajit e bën në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, nuk e kam ditur që është e ndaluar loja e bixhozit, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso lloj vepre penale, lus gjykatën që të më shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.

I pandehuri i dytë në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mundën të vijnë, pranimin e fajit e bën në mënyrë vullnetare, ndihet thellë i penduar, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, jam penduar siç thash edhe më herët dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso lloj veprime andaj dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptojë dënim sa më të butë që është e mundur.

I pandehuri i tretë në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mundën të vijnë, pranimin e fajit e bën në mënyrë vullnetare, ndihet thellë i penduar, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso vepre penale, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, lus gjykatën që mundësisht të më shqiptojë një dënim sa më të ulët për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

I pandehuri i katërt në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mundën të vijnë, pranimin e fajit e bën në mënyrë vullnetare, ndihet thellë i penduar, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso vepre penale, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, lus gjykatën që mundësisht të më shqiptojë një dënim sa më të ulët për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

I pandehuri i pestë në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mundën të vijnë, pranimin e fajit e bën në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, edhe unë si kolegët e mi premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso vepre penale, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, lus gjykatën që mundësisht të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

I pandehuri i gjashtë në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mundën të vijnë, pranimin e fajit e bën në mënyrë vullnetare, ndihet thellë i penduar, ka qenë e rastit dhe lus gjykatën që të më shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, pasi që është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin.

I pandehuri i shtatë në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mundën të vijnë, pranimin e fajit e bën në mënyrë vullnetare, ndihet thellë i penduar, premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë një vepër të tillë, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin dhe besoj se e dhe hera e fundit, dhe lus gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit të më shqiptojë dënim sa më të butë që është e mundur.

I pandehuri i tetë në shqyrtimin gjyqësor fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mundën të vijnë, pranimin e fajit e bën në mënyrë vullnetare, ndihet thellë i penduar, është hera e parë që kam kryer këso vepre penale dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej këso vepre penale apo të ngjashme, pasi që unë jam punëtor punoj si auto mekanik dhe nuk kam kohë të merrem me këso veprime.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurve ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve A.I., J.S., B.I., A.T., A.B., M.R., R.M. dhe S.M. për veprën penale që i ngarkon kjo aktakuzë, pasi që një pranim i tillë nga ana e tyre është bërë në mënyrë vullnetare dhe korrekte duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë ku një pranim i tillë është bërë në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPPRK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban kjo aktakuzë. Andaj i propozoj gjykatë që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të ju shqiptoj një sanksion penal sipas ligjit, përkitazi për caktimin dhe llojin lidhur me lartësinë e dënimit i propozoj kësaj gjykate që ti ketë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese me qëllim që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërisë si dhe pasojën e shkaktuar nga kjo vepër penale.

Mbrojtësi i të pandehurit të parë lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin e tij ka deklaruar se, me të mbrojturin tim paraprakisht kishim konsultime e të cilin e kisha njoftuar se nëse e pranon fajësinë ka beneficione dhe pasoja, andaj është pajtuar që të pranon fajësinë dhe kërkojmë nga gjykata që të aprovohet pranimi i fajësisë. Meqenëse i mbrojturi im ka pranuar fajësinë në këtë fazë të procedurës gjykata të merr si rrethanë posaçërisht lehtësuese si dhe rrethanat tjera është i moshës relativisht i ri, është penduar, nuk ka kryer vepër tjetër penale prej këtij momenti si dhe premtan se do të sillet sipas normave ligjore, morale etj, andaj kërkoj nga gjykata që të mbrojturit tim ti shqiptoj një dënim minimal me gjobë.

Mbrojtësi i të pandehurit të dytë lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin e tij ka deklaruar se, pas konsultimit me të mbrojturin tim dhe pasi u njoftua me të drejtat dhe obligimet ligjore i njëjti në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë për veprën që e ngarkon aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që në pajtim me dispozitat ligjore të pranoj pranimin e fajësisë, i propozoj gjykatës që si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh pranimin e fajësisë, moshën relativisht të re të tij, është penduar për veprën e kryer,

nuk ka kryer veprë penale tjetër dhe është zotuar se nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, andaj i propozoj gjykatës që të mbrojturit tim ti shqiptoj një dënim sa më të ulët me gjobë i cili edhe do të arrin qëllimin e dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit të tretë lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin e tij ka deklaruar se, pajtohem me deklarin e të mbrojturit tim lidhur me pranimin e fajësisë, andaj i propozoj gjykatë, që të pranoj pranimin e fajësisë nga ana e tij. Kjo pasi që i mbrojturi im pranimin m e fajësisë e ka bërë pas konsultimeve të nevojshme me mua si mbrojtës i tij, e që një pranim është në përputhje të plotë me, dispozitat e KPRK-së. Nga kjo arsye i propozoj gjykatë që me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësueses që i parasheh ligji , si dhe rrethanave faktike që i deklaroi i mbrojturi im siq janë : se ai nuk është dënuar asnjëherë më parë është në gjendje të vështirë ekonomike, e ka pranuar fajësinë, është penduar thellë për veprën e kryer se deklaroi se në të ardhmen asnjëherë nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme. Nga këto arsye i propozoj gjykatës që duke pasur parasysh dispozitat ligjore për zbutje të dënimit, posaçërisht rrethanën e pranimin të fajësisë të njëjtë ti shqiptohet dënim minimal me gjobë, ose nëse dispozitat e përmendura nuk parashohin mundësin e dhënies së dënimit me gjobë atëherë të shqiptoj një dënim minimal me burg e që i njëjti me pajtimin e të pandehurit ti zëvendësohet me dënim me gjobë, i cili gjithashtu të jetë minimal për shkak të gjendjes ekonomike të të pandehurit me bindje se një dënim i tillë do të ndikonte mjaftueshëm në qëllimin e dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit të katërt lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin e tij ka deklaruar se, në këtë seancë të shqyrtimit penal si dhe në fazën paraprake i pandehuri A.T. në mënyrë të vullnetshme pa kurrfarë presioni e ka pranuar fajësinë në tërësi si në dispozitivin e aktakuzës së prokurorisë. Pranimi i fajësisë është bërë në këshillim me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare dhe me këtë rast i propozoj gjykatës që duke aplikuar institutin e zbutjes së dënimit lidhur me këtë veprë penale ti zëvendësohet me dënim me gjobë lartësia e të cilit do të ishte në nivel të arsyeshëm duke ndikuar pozitivisht në personalitetin e të pandehurit, Si rrethana lehtësuese gjykata të vlerësoj se i pandehuri është i moshës së re, ka qenë kohë pandemie dhe mundësisht dënimi të jetë në harmoni me praktikën.

Mbrojtësi i të pandehurit të pestë lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin e tij ka deklaruar se, i mbrojturi im sapo e bëri pranimin e fajësisë rreth pikës dy të dispozitivit të aktakuzës në fjalë që i vihet në barrë edhe ne si mbrojtje këtë pranim të fajësis nga i mbrojturi im e përkrahim, pasi që pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë pas konsultimeve të

mjaftueshme me mua si mbrojtëse e tij, pas shpjegimit për benefitet rreth pranimin të fajësisë dhe i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, për qka konsiderojmë se janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 241 të KPPRK-së m, të pranohet pranimi i fajësisë pasi që i njëjti është në harmoni me dispozitivin akuzues si dhe me provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, për qka i propozojmë gjykatës që të pranoj.

Gjatë shqiptimit të dënimit në raport me veprën që e ka kryer i mbrojturi im i propozojmë gjykatës që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë rrethanën, pranimin e fajësis nga i mbrojturi im, moshën e tij, faktin se i njëjti ka qenë bashkëpunues nga fillimi gjer më tani, fakti se i njëjti nuk ka qenë 9i dënuar asnjëherë më parë, faktin se i njëjti po kërkon falje për veprimet që i ka ndërmarr dhe premtion se në të ardhmen do të tregohet më vigjilent dhe nuk do të kryej asnjë veprim që përbën shkelje penale, andaj besojmë dhe shpresoj që nga të lartcekurat që gjykata të merr parasysh dhe gjatë shqiptimit të dënimit të shqiptoj dënim sa më të ulët dhe dënimin me burg, i cili dënim- të konverohet në dënim me gjobë dhe gjykata gjatë caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë të ketë parasysh se i njëjti është mbajtës i familjes dhe që të mos dëmtohet mirëqenia e familjes ngase besojmë që me dënim sa më të ulët do të arrihet qëllimi i dënimit dhe që ai dënim do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin në shoqëri.

Mbrojtësi i të pandehurit të gjashtë lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin e tij ka deklaruar se, pranimi i fajësisë nga i mbrojturi im u bë pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës i tij duke u bazuar në shkresat dhe provat e lëndës andaj i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë të aprovojë. Pajtohem me kolegët e mi avokat parafolës për sa i përket shumicës së rrethanave lehtësuese dhe shqiptimit të dënimit andaj japim miratimin edhe ne që një dënim minimal do të ishte i mjaftueshëm që të njëjtën veprë të mos e përsërit dhe i mbrojturi im të kuptoj rëndësinë e kësaj veprë. Më duhet të ritheksoj vetëm dy çështje të rrethanave personale të cilat konsiderojmë se gjykata duhet të ketë parasysh gjatë marrjes së vendimit për dënim, i mbrojturi im është kujdestar përcjellës i dy familjarëve të tij i motrës dhe babait të tij të cilët kanë çrregullime mendore, andaj me rastin e matjes së dënimit të kihet parasysh që të mos ndikoj dënimin edhe tek persona e tjerë, çështja e dytë ka të bëjë me kontributin minimal në veprë me që i njëjti rastësisht dhe afërsisht ka qenë në dyqanin e lagjes.

Mbrojtësi i të pandehurit të shtatë lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin e tij ka deklaruar se, e mbështes pranimin e fajësisë, pranim për të cilin i mbrojturi im kishte vendosur para se të vinte në këtë gjykatore dhe kërkoj nga gjykata që ta miratoj këtë pranim

fajësie dhe të marr si rrethanë veçanërisht lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit. Sa i përket shqiptimit të dënimit i mbështet kolegët e mi dhe kërkoj të gjitha rrethanat e propozuara nga ata të konsumohen edhe te i mbrojturi im, kërkoj nga ju që të zbatoni dispozitën e nenit 71 dhe 72 të KPRK-së lidhur me zbutjen e dënimit dhe të mbrojturit tim ti shqiptoni një dënim nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 72 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit të tetë lidhur me pranimin e fajësisë për të mbrojturin e tij ka deklaruar se, e mbështes deklarin e të mbrojturit tim lidhur me pranimin e fajësisë, i njëjti këtë pranim e ka bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mua si mbrojtës, andaj gjykatës i propozoj që ta aprovoj këtë pranim të fajësisë, po ashtu gjykatës i propozoj që gjatë caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh si rrethanë lehtësuese, pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar si dhe rrethanat tjera lehtësueses duke qenë se i njëjti në të kaluarën nuk ka kryer veprë tjetër penale, është penduar për kryerjen e saj dhe premtion se në të ardhmen nuk do të kryer veprë tjetër penale. Andaj pas shqyrtimit të këtyre rrethanave gjykatës i propozoj që ndaj të mbrojturit tim të shqiptojë minimumin e dënimit dhe të njëjtit të ia zëvendësoj me gjobë me çka edhe do të arrihet qëllimi i dënimit meqenëse i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit e kanë bërë vullnetarisht, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Raporti i oficerit 2021-CF-2... i dt.31.10.2021, Deklaratat e dëshmitarëve R. I., M..R., B. I., D. M., Deklaratat e të pandehurve S.M. e dt.31.10.2021, Deklarata e të pandehurit R.M. e dt.31.10.2021, Deklarata e të pandehurit M.R. e dt.31.10.2021, Deklarata e të pandehurit A.B. e dt.31.10.2021, Deklarata e të pandehurit A.T. i dt.31.10.2021, Deklarata e të pandehurit B.I. i dt.31.10.2021, Deklarata e të pandehurit J.S. i dt.31.10.2021, Deklarata e të pandehurit A.I. i dt.31.10.2021, Fotoalbumi nga Njësia e Teknikës Kriminallistike nr.2021-CF-2199 i dt.31.10.2021, Deklarata e të pandehurit A.I. e dhënë në Prokurori e dt.04.11.2021, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse të gjithë të pandehurit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkuara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të

KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitivet e këtij aktgjykimi, në të cilat janë përshkruar datat, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprave penale për çka dhe të pandehurit u shpallën fajtorë dhe iu shqiptuan dënimet siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti për të gjithë të pandehurit si rrethana veçanërisht lehtësuese se të njëjtit që në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë, pendimin dhe premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin kësi lloj veprë penale apo të ngjashme, se më parë asnjëri prej tyre nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale me aktgjykim të formës së prerë, se përveç të pandehurit të katërt të gjithë të tjerët kanë gjendje jo të mirë ekonomike, ndërsa në mungesë të ndonjë rrethane rënduese për të njëjtit vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tilla, duke marrë parasysh edhe faktin se të pandehurit kanë bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimet e shqiptuara janë plotësisht të justifikueshme, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e tyre dhe të autorëve të tyre, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për konfiskim, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 276 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2021:250047, i datës 12.04.2023

Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.